



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Letër për mbështetje dhe bashkëfinancim të Projektit

Me këtë dokument, Komuna e Lipjanit konfirmon se mbështetë plotësisht OJQ-në "Advancing Together" e cila është zbatuese e projektit "Bëhu Partneri im për Mirëqenie" i financuar nga UNMIK.

Lidhur me Projektin për rrënimin e ish - objektit të vjetër të Pensionistëve në Janjevë, Komuna është plotësisht e gatshme të bashkëpunojë me OJQ-në "Advancing Together" e cila ka marrë përsipër ta bëjë rrënimin e objektit të lartëcekur.

Komuna e Lipjanit konsideron se projekt i përrënimin e objektit të vjetër të pensionistëve në Janjevë do të kontribonte shumë në ndërtimin e besimit dhe ndërveprimit mes të gjitha komuniteteve që jetojnë në këtë fshat dhe lidhur me këtë Komuna planifikon të ndërtoj një park rekreativ në hapësirën e cila do të krijohet me rrënimin e këtij objekti.

Lidhur me këtë projekt Komuna e Lipjanit **zotohet** se pasi që OJQ "Advancing Together" ta rrënojë objektin e lartëpërmendur do ta ndërtoj një park rekreativ .

1Nr. 1-h53/01-10327

Lipjan, më 16.02.2024





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Letër për mbështetje dhe bashkëfinancim të Projektit

Me këtë dokument, Komuna e Lipjanit konfirmon se mbështetë plotësisht OJQ-në "Advancing Together" e cila është zbatuese e projektit "Bëhu Partneri im për Mirëqenie" i financuar nga UNMIK.

Përkitazi me këtë, nëse projekt-propozimi "Rrënimi i Objekteve Administrative të ish-Minierës së Linjtit" e cila gjendet në qendër të fshatit Magurë miratohet nga donatori, Komuna është plotësisht e gatshme të bashkëfinancojë projektin në Marrëveshje të plotë, duke identifikuar dhe specifikuar pozicionet dhe përgjegjësitë e secilës palë të përfshirë në zbatimin e këtij Projekti.

Komuna e Lipjanit konsideron se projekti "Rrënimi i objekteve administrative të ish-Minierës së Linjtit- Magurë" do të kontribonte shumë në ndërtimin e besimit dhe ndërveprimit mes të gjitha komuniteteve që jetojnë në këtë fshat dhe lidhur me këtë Komuna planifikon të ndërtoj një park rekreativ në hapësirën e cila do të krijohet me rrënimin e këtyre ndërtesave.

Lidhur me bashkëfinancimin e Projektit të cekur Komuna zotohet se pasi që OJQ "Advancing Together" ta finacojë projektin në shumë prej 10,000.00 € (dhjetë mijë euro) pjesën tjetër të mbetur do ta -mbulojë- bashkëfinancojë Komuna e Lipjanit.

1Nr. 453/01-8909
Lipjan, më 13.02.2024

Z. IMRI AHMETI
KRYETAR I KOMUNËS





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN

MEMORANDUM MIRËKUPTIMI

#13/2024 MoU

Pranuar më:	29.01.2024	
Primljeni:		
Njësia Jednica	Numri Broj	Shtojca Dodatak
01-332/05-21119		

Ndërmjet

SWISSCONTACT, përfaqësuar nga Fisnik Reçica, Menaxher i Projektit "Promovimi i Punësimit në Sektorin Privat" (PPSE), Prishtinë,

KOMUNA E FUSHË KOSOVËS, përfaqësuar nga Burim Berisha, Kryetar,

KOMUNA E LIPJANIT, përfaqësuar nga Imri Ahmeti, Kryetar,

dhe

ASOCIACIONI I KOMUNAVE TË KOSOVËS, përfaqësuar nga Sazan Ibrahim, Drejtor Ekzekutiv.

Neni 1

QËLLIMI

Në përputhje me objektivat e PPSE-së për fuqizimin e turizmit të qëndrueshëm në Komunat e Republikës së Kosovës;

Në linjë me bashkëpunimin e konsoliduar me Asociacionin e Komunave të Kosovës për të lehtësuar shkëmbimin e njohurive, ngritjen e kapaciteteve lokale për zhvillimin e produkteve turistike dhe fuqizimin e ekonomisë lokale;

Në pajtim me objektivat strategjike të komunave pjesëmarrëse për zhvillimin e projekteve që kontribuojnë në zhvillimin e qëndrueshëm të turizmit lokal dhe krijimin e vendeve të punës, palët lidhin këtë memorandum mirëkuptimi përmes të cilit synohet bashkëpunimi

- 3.5. Ndan raportin e draftuar nga ekspertët e Kompanisë EPODE me Komunat dhe adreson çështjet e dalura nga ky raport.

Neni 4

KOORDINIMI DHE KONSULTIMET

- 4.1. Palët pajtohen që gjatë zbatimit të kësaj marrëveshje, do të shkëmbejnë informacione dhe do të takohen sipas nevojës për të vlerësuar dinamikat e implementimit të marrëveshjes dhe efektivitetin e mbështetjes.
- 4.2. Raporti i Vlerësimit i përgatitur nga kompania EPODE nuk do të jetë dokument obligativ për zbatim, por do të përbajë vlerësimë, sugjerime dhe rekomandime profesionale për zhvillim të produkteve turistike në Majën e Goleshit.
- 4.3. Çdo mosmarrëveshje që ka të bëjë me administrimin dhe implementimin e Marrëveshjes së Mirëkuptimit do të zgjidhet nëpërmjet konsultave të palëve në fjalë.
- 4.4. Nëse palët nuk mund t'i zgjidhin mosmarrëveshjet sipas pikës 4.3. të këtij nenii, kompetent për këtë do të jetë gjykata kompetente.

Neni 5

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

- 5.1. Amandamentimi apo shkëputja e marrëveshjes: Palët kanë të drejtë të amandamentojnë apo shkëpusin pjesëmarrjen në marrëveshje duke dërguar paralajmërim me shkrim 30 ditë më herët.
- 5.2. Kohëzgjatja e kësaj marrëveshje është nga data e nënshkrimit nga të gjitha palët deri më 31 dhjetor 2024.
- 5.3. Palët në këtë marrëveshje do të përfaqësohen nga personat e autorizuar nga nënshkruesit e marrëveshjes.
- 5.4. Palët duhet të veprojnë në besueshmëri të plotë për të siguruar arritjen e të gjitha objektivave të marrëveshjes.


Neni 6


HYRJA NË FUQI

Ky Memorandum Mirëkuptimi i hartuar në katër kopje identike hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga ana e të gjitha palëve.

Më 04 prill, 2024

Sazan Ibrahim, Drejtor Ekzekutiv, Asociacioni i Komunave të Kosovës 

Fisnik Reçica, Swisscontact, Menaxher i Projektit 

Burim Berisha, Kryetar i Komunës së Fushë Kosovës 

Imri Ahmeti, Kryetar i Komunës së Lipjanit 



REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA LIPJAN
REPUBLIKA KOSOVO
OPŠTINA LIPLJAN

01 Nr.Br. 400/01-20407
Data/Datum 24.04.2024



Marrëveshje Bashkëfinancimi

në mes të

Advancing Together dhe Komunës së Lipjanit

Bazuar në Marrëveshjen e Bashkëpunimit, të nënshkruar në mes Komunës së Lipjanit dhe OJQ Advancing Together me datë 17. 10. 2023, protokoluar me Nr. 01-660/03-59627.

Me këtë dokument- Marrëveshje, Komuna e Lipjanit konfirmon se mbështetë plotësisht OJQ-në “Advancing Together”, e cila është zbatuese e projektit “Bëhu Partneri im Për Mirëqenje” i financuar nga UNMIK.

Përkitazi me këtë, Komuna e Lipjanit zotohet se do të bashkëfinancojë projekte e dhëna në vazhdim në Marrëveshje të plotë, duke identifikuar dhe specifikuar pozicionet dhe përgjegjësitë e secilës palë të përfshirë në zbatimin e këtyre Projekteve ndërsa transferimin e mjeteve financiare do ta bëjë sipas situacionit dhe punëve të nënshkruara nga Menaxheri i kontratës.

Marrëveshja bëhet për projekte e paraqitura më poshtë për të cilat Komuna e Lipjanit konsideron se do të kontribuojnë në ndërtimin e besimit dhe ndërvëprimit mes të gjitha komuniteteve që jetojnë në këtë Komunë.

Afat i zbatimit të Marrëveshjes së Bashkëfinancimit është jo më larg se në fund të muajit nëntor 2024.

Obligimi i palëve:

- OJQ “Advancing Together” do të financojë projeket në vlerë prej 21,000.00 € (njëzet e një mijë euro).
- OJQ “Advancing Together” merr përsipër të zbatojë të gjitha procedurat e prokurimit për projekte e dhëna në harmoni me legjisacionin në fuqi të Republikës së Kosovës.
- Komuna e Lipjanit do të marrë pjesë me shumën prej 31,711.37 € (tridhjetë e një mijë e shtatëqind e njëmbëdhjetë euro e tridhjetë e shtatë cent), e cila do të transferohet në llogarinë bankare të OJQ-së “Advancing Together” ProCredit Bank 1189-006005-0001-58

- Në rast të tejkalimit të shumës së paraparë për bashkëfinancim, Komuna e Lipjanit obligohet të mbulojë shumën e mbetur dhe jo më shumë se 10% të shumës totale të lartpërmendur për bashkëfinancim nga palët.
- Komuna e Lipjanit merr përsipër, sipas projekteve: monitorimin e realizimit të të gjitha projekteve dhe aktiviteteve, monitorimin e punëve ndërtimore:
 - Kroni i Qylagës – fshati Qylagë,
 - Objektet Administrative të ish-Minierës - qyteza Magurë (rrënimi i tyre)
 - Objekti ‘Qendra Rinore/Shoqata e Pensionistëve’ – fshati Janjevë
 - ‘Qendra e Qëndrimit Ditorë për Fëmijët’ - fshati Gadime.

Komuna e Lipjanit gjatë procesit të rrënimit të Objekteve Administrative të ish-Minierës - qyteza Magurë do të caktojë një zyrtar përgjegjës komunal që do të bëjë monitorimin e zhvillimit të procesit të rrënimit.

- Në rast të mosbatimit të Marrëveshjes, fondet e transferuara nga Komuna e Lipjanit në Ilogarinë e OJQ-së “Advancing Together”, ProCredit Bank 1189-006005-0001-58, do të kthehen në Ilogarinë e Komunës Lipjan, BQK (Banka Qëndrore e Kosovës) 1000650150000190.
- Komuna e Lipjanit do të caktojë një zyrtar të Drejtorisë së Financave (ose tjetër) për koordinim me OJQ-në "Advancing Together" dhe për të raportuar për ecurinë e zbatimit të kësaj Marrëveshje.

Interpretimi dhe Ndryshimi

Interpretimi i kësaj Marrëveshje të Bashkëfinancimit do të bëhet në pajtim me ligjet e Kosovës duke e ruajtur parimin e reciprocitetit.

Ndryshimet dhe plotësimet e kësaj Marrëveshje të Bashkëfinancimit mund të bëhen vetëm me shkrim të nënshkruara nga ana e të dy palëve.

Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve

Palët zotohen se do t'i përbahen kësaj marrëveshje të bashkëfinancimit dhe se në rast kontesti eventual apo paqartësive në tekstin e kësaj Marrëveshje, të zgjidhen me anë të bisedimeve, konsultimeve miqësore dhe me mirëkuptim, e në rast se kjo nuk arrihet, kompetente do të jetë Gjykata Themelore në Prishtinë, Dega në Lipjan.

Shkëputja e Marrëveshjes

E drejta e shkëputjes së njëanshme të kësaj Marrëveshje të bashkëfinancimit, do të bëhet në rastet e shkeljeve të obligimeve që janë të përcaktuara me këtë Marrëveshje të bashkëfinancimit, duke e njoftuar palën tjetër 30 (tridhjetë) ditë para shkëputjes së Marrëveshjes.

Hyrja në Fuqi

Kjo marrëveshje e Bashkëfinancimit hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga ana e palëve nënshkruese.

Projektet:

1/ Renovimi i Kronit të Qylagës, fshati Qylagë.

<u>Buxheti total për projekt</u>	-----	€ 3,000.00
Financimi nga Advancing Together	-----	€ 3,000.00
Financimi nga Komuna	-----	€ 0.00

2./ Mundësimi i qasjes në Qendrën Rinore në Janjevë.

<u>Buxheti total për projekt</u>	-----	€ 3,000.00
Financimi nga Advancing Together	-----	€ 3,000.00
Financimi nga Komuna	-----	€ 0.00

3./ Faza fillestare për parkun qëndror të qytetës Magurë (*rrënimi i objekteve të ish-Minierës*).

<u>Buxheti total për projekt</u>	-----	€ 37,750.00
Financimi nga Advancing Together	-----	€ 10,000.00
Financimi nga Komuna	-----	€ 27,750.00

4./ Asamblea Rinore - Fuqizimi i Liderëve të Ardhshëm të Lipjanit

<u>Buxheti total për projekt</u>	-----	€ 3,000.00
Financimi nga Advancing Together	-----	€ 3,000.00
Financimi nga Komuna	-----	€ 0.00

5./ Ndërtimi i kopshtit 'Qendra Ditore e Fëmijëve' - fshati Gadime

<u>Buxheti total për projekt</u>	-----	€ 5,961.37
Financimi nga Advancing Together	-----	€ 2,000.00
Financimi nga Komuna	-----	€ 3,961.37

Advancing Together

Drejtor Ekzekutiv



Komuna e Lipjanit

Kryetar i Komunës

Imri Ahmeti





SOS FSHATRAT
E FËMIJËVE
KOSOVË

RÉPUBLIQUE DU KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVË
KOMUNA E LIPJANËS
OPŠTINA LIPLJAN

Pranuar me:	26.04.2024	
Primljen:		
Mjësia Jednica	Numri Sroj	Shtoja Dodatak
03-560/03-20791		



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

SOS FSHATRAT E FËMIJËVE KOSOVË me numër të regjistrimit 5200200-1 dhe adresë në rr. 1 Tetori p.n. Velania, 10000, Prishtinë, Kosovë

dhe

Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale në Lipjan

lidhin këtë

Marrëveshje Bashkëpunimi

Marrëveshja për Bashkëpunim synon të koordinojë aktivitetet për të përmirësuar cilësinë e shërbimeve të ofruara nga SOS Fshatrat e Fëmijëve Kosovë përmes Qendrës Mbështetëse për Familjet Strehuese.

SOS Fshatrat e Fëmijëve Kosovë është organizatë joqeveritare e përkujdesjes sociale e dedikuar për përkrahjen e fëmijëve dhe te rijnë pa përkujdesje prindërore dhe në nevojë pa marrë parasysh moshën, gjininë, etninë, nivelin e arsimimit dhe besimin fetar.

Përmes kësaj marrëveshjeje, Qendra Mbështetëse për Familjet Strehuese ofron shërbime të ndryshme për fuqizimin e familjeve strehuese dhe adoptuese. Kjo përfshin ofrimin e shërbimeve direkte psiko-sociale për fëmijët dhe prindërit strehues, si dhe ngritjen e kapaciteteve përmes Programit për Prindër PRIDE për të përbushur standarde tregtare.

Për të arritur qëllimin më lartë, palët e lartpërmendura pajtohen si në vijim:

I. Objekti i marrëveshjes

1. Objekti i kësaj Marrëveshjeje është bashkëpunimi mes palëve, për të bashkërenduar veprimet dhe aktivitetet që synojnë përmirësimin dhe avancimin e mirëqenies së fëmijëve dhe familjeve në Komunën e Lipjanit.

2. Kjo Marrëveshje lidhet për periudhë të pacaktuar kohore.

II. Obligimet dhe përgjegjësítë e SOS Fshatrat e Fëmijëve Kosovë:

1. Mbështetja e QPS-së në procesin e identifikimit, selektimit, përgatitjes dhe referimit te familjeve strehuese,
2. Do të monitoroj dhe vlerësoj progresin e përfituesve,
3. Të raportoj në baza periodike për progresin e fëmijëve dhe familjeve strehuese,
4. Përcjell lëndën e rasteve të fëmijëve apo familjeve strehuese të shërbimeve nga SOS, tek menaxheri i rastit në QPS sipas kërkesës,
5. Të mundësoj ofrimin e punëtorive dhe trajnimeve të cilat kanë karakter të zhvillimit profesional të stafit të QPS.

SOS Fshatrat e Fëmijëve Kosovë ne bashkëpunim, do të jetë përgjegjës për kryerjen e aktiviteteve të përshkruara në këtë marrëveshje si me poshtë:

- Aktivitete psiko-sociale, aktivitete psiko-fizike dhe edukative për fëmijë dhe të rinjë;
 - Vlerësim bazë i familjeve strehuese;
 - Vlerësim psikologjik, psikoterapi për fëmijë, të rinj dhe familje strehuese;
 - Këshillim psikosocial dhe pedagogjik për fëmijë, të rinjë, prindër strehues;
 - Përkrahja e prindërve strehues në ofrimin e mbrojtjes dhe kujdesit cilësor për fëmijët;
 - Sigurimi i këshillimeve individuale dhe grupore për fëmijët, të rinjtë dhe prindër strehues;
 - Vizita dhe këshillime në familje strehues;
 - Lehtësim dhe asistencë për fëmijë, të rinj e vendosur ne familje strehuese në marrjen e shërbimeve dhe përfitimeve tjera nga komuniteti (shëndetësi, çështje ligjore, etj);
 - Sigurimi i trajnimeve të ndryshme për prindër strehues për ngritjen e shkathtësive për ofrimin e kujdesit cilësor për fëmijë;
 - Ngritja e kapaciteteve për prindërit strehues dhe adoptues përmes Programit për Prindër përmes Metodologjisë PRIDE;
2. Shkëmbimi i përvojave në mes të Programeve të SOS Fshatrat e Fëmijëve dhe Drejtoratit për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale në Lipjan.
- Pjesëmarraja në trajnime, grupe punuese dhe aktivitete të ndryshme të organizuara për ngritjen e kapaciteteve të stafit në mënyrë që të ofrohen shërbime cilësore për përfituesit,
 - Pjesëmarraja e stafit multidisiplinar në tryezat multidisiplinare për ndihmë në menaxhimin e rastit,
 - Mundësia e shfrytëzimit reciprok të hapësirave mes SOS Fshatrave të Fëmijëve dhe QPS Lipjanit në realizim të aktiviteteve mbështetëse për përfitues dhe për takime individuale.

III. Obligimet dhe përgjegjësitë e Drejtorisë për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale përmes Qendrës për Punë Sociale në Lipjan.

Obligimet dhe përgjegjësitë e Qendrës për Punë Sociale në Lipjan janë si në vijim:

1. Të bashkëpunoj me SOS Fshatrat e Fëmijëve Kosovë, në procesin e identifikimit, selektimit, përgatitjes dhe referimit te familjeve strehuese,
2. Siguron pjesëmarrjen dhe përfaqësimin e Kujdestarit Ligjor ose Menaxherit të Rastit në të gjitha rastet kur kërcohët prezenca e tyre, në funksion të interesit më të mirë të fëmijës,
3. Pjesëmarra aktive e Zyrtarit të Shërbimeve Sociale të Qendrës për Punë Sociale në vizitën e vlerësimit të përfituesit,

- Organizimi i përbashkët i aktiviteteve për përfituesit,
- Organizimi i takimeve periodike të stafit të dy Institucioneve me qëllim të shkëmbimit të përvojave të punës.

IV. Shkëputja e Marrëveshjes

1. Kjo marrëveshje hyn në fuqi nga data e nënshkrimit.

2. Kjo marrëveshje e vullnetit të mirë të palëve mund të shkëputet me mirëkuptim nga të dyja palët përmes marrëveshjes me shkrim në çdo kohë, apo me kërkesë të njërsë palë, me paralajmërim paraprak me shkrim prej 30 ditëve kalendarike, me paraqitje të arsyeve të cilat shpijnë drejt shkëputjes së marrëveshjes.

3. Shkëputja e Marrëveshjes nuk shkakton pasoja për palën që ka inicuar shkëputjen e saj, me përjashtim të detyrimit të kompenzimit të atyre dëmeve të shkaktuara me qëllim apo nga pakujdesia e rëndë gjatë zbatimit të saj

V. Të tjera

1. Kjo marrëveshje përgatitet në dy versione origjinale, nga një për secilën prej palëve.

Drejtor i Programit të SOS Fshatit të Fëmijëve,
Lokacioni Prishtinë

Drejtor i Drejtorisë për Shëndetësi dhe
Përkujdesje Sociale

Ora Bytyçi



Lipjan,
26.04.2024

Shkelzen Hajdini



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO	
MINISTRIA E MJEDISIT, PLANIFIKIMIT HAPËSINOR DHE INFRASTRUKTURËS	
MINISTARSTVO ŽIVOTNE SREDINE, PROSTORNOG PLANIRANJA I INFRASTRUKTURE	
MINISTRY OF ENVIRONMENT, SPATIAL PLANNING AND INFRASTRUCTURE	
Njësia org. Org.Jedinica Org.Unit Nr.i Faqeve Nr.Stranica Nr.Pages	MMPHI 2
Nr.i Prot. Broj Prot. Prot.No.	3618/24
Datum: Date:	06.06.2024
PRICHTIMI / A No. 1	



Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Environment, Spatial Planning and Infrastructure

KERFOUDIJA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVO
OPŠTINA LIPLJAN

Pranuar me: Primljen:	06.06.2024	
Njësia Jedinica	Numri Broj	Shtoja Dodatak
01-352/01	-27713	



Komuna e Lipjanit
Opštine Lipjane
Municipality Lipjan

Dokumenti për pranim/dorëzimin e të mirave materiale, të përfituar nga Granti i Përformancess për Mjedis të Pastër

Procesverbali i dorëzimit të kontejnerëve

Komuna përfituese

Lipjani

Qeveria e Republikës së Kosovës

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës

Titulli i Projektit:

Skema e Grantit të Performancës Komunale- Mjedis i Pastër

Kontinjerët në listën e bashkëngjitur është dorëzuar me datë

05.06.2024

Nga (emri dhe pozita)

Zëvendesuesi i Sekretarit të Përgjithshëm të MMPHI,
z. Izedin Bytyqi , z. Jeton Raka zv. Ministër i MMPHI-së

Përfaqësuesi i Institucionit zbatues të projektit (emri dhe pozita)

Kryetar i komunës së Lipjanit
z. Imri Ahmeti

Kontejnerët duhet te jenë funksional dhe në gjendje operimi me qëllim që të sigurohet shërbim efikas dhe kualitativ për komunën.

Me dorëzimin e pajisjeve, të gjitha të drejtat dhe detyrimet në lidhje me pajisjet e listuara i barten komunës.
Megjithatë, pajisjet do të jenë në dispozicion të pakufizuar të komunës.

Kontejnerët e fituar

Kontejnerë 1.1 m³ metalik ; Kontejnerë të plastikës 120 L

Vendi, data dhe nënshkrimi:

Prishtinë, 05.06.2024

Dorëzuar nga MMPHI:

Pranuar nga Komuna e Lipjanit:

z. Izedin Bytyqi Zëvendesuesi i Sekretarit të Përgjithshëm të MMPHI-së	z. Jeton Raka zv. Ministër i MMPHI-së	z. Imri Ahmeti Kryetar i Komunës së Lipjanit



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government

*Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Životne sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure*

**Dorëzimi i të mirave materiale, të përfituar nga Granti i Përformances për Mjedis
të Pastër në Komunën e Lipjanit**

Artikulli Nr.	Përshkrim	Copë	Çmimi për njësi me TVSH	Totali €
1.	Kontejnerë 1.1 m ³ metalik	117	421.00€	49, 257.00 €
2.	Kontejnerë të plastikës 120L	1100	26.89€	29,579.00€
Shuma totale:				78, 836.00 €

Data e pranimit:

Nënshkrimi dhe vula

Z. Imri Ahmeti
Kryetari i Komunës

REPUBLIKE E KOSOVËS
REPUBLIKA SFR YUGOSLAVIA
RÉPUBLIQUE DU KOSOVO
REPÚBLICA DE KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVO
OPŠTINA LIPJAN

Pranuar më:	02-05-2024	
Primiljen:	Njësi	Shtoja
Jednica	Braji	Dodatak
01-660/04-22210		



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe
Infrastrukturës
Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i
Infrastrukture
Ministry of Environment, Spatial Planning and
Infrastructure

REPUBLICA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVO / REPUBLIC OF KOSOVO
MINISTRIA E MJEDISIT, PLANIFIKIMIT HAPËSINOR DHE INFRASTRUKTURE
MINISTARSTVO ŽIVOTNE SREDINE, PROSTORNOG PLANIRANJA I INFRASTRUKTURE
MINISTRY OF ENVIRONMENT, SPATIAL PLANNING AND INFRASTRUCTURE

M - 01
04
2362/24
08.05.24
PRISHTINË / A
Na 1



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komuna e Lipjanit
Municipality of Lipjan
Opština Lipjan

MEMORANDUM I MIRËKUPTIMIT PËR FINANCIMIN E PROJEKTEVE
INFRASTRUKTURORE

MINISTRIA E MJEDISIT PLANIFIKIMIT HAPËSINOR
DHE INFRASTRUKTURËS

DHE

KOMUNA E LIPJANIT

Prishtinë, Maj 2024

1 | F a q e

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës

Neni 1
Palët Nënshkruese

1. **MINISTRIA E MJEDISIT PLANIFIKIMIT HAPËSINOR DHE INFRASTRUKTURËS,** e përfaqësuar nga Zv. Ministri i MMPHI-së, (në tekstin e mëtejmë MMPHI),
dhe
2. **KOMUNA E LIPJANIT**, e përfaqësuar nga Kryetari i Komunës, (në tekstin e mëtejmë Komuna).

Neni 2
Qëllimi

Qëllimi i këtij Memorandumi është financimi i projekteve infrastrukturore të cekura më poshtë si dhe përcaktimi i obligimeve të MMPHI-së dhe Komunës për realizimin e projekteve:

1. **Ndërtimi i Urës mbi Lumin Sitnicë**, kodi i projektit nr.10041 në vlerë prej **370,000.00 €**.
 - Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës e finançon projektin me 370,000 €, ndarjet buxhetore për vitin 2024 janë 70,000 €, ndërsa për dy vitet në vijim mjetet buxhetore të parashikuara janë 300,000 €;

Neni 3
Obligimet e MMPHI-së

1. MMPHI-ja i siguron mjetet për projektet nga neni 2, paragrafi 1 i këtij Memorandumi dhe nga një kopje i dërgon Komunës.
2. C'do tejkalim i vlerës së planifikuar për projektet nga neni 2, paragrafi 1 i këtij Memorandumi do të mbulohet nga Komuna.
3. Pagesat për financim të projekteve nga MMPHI-ja do të bëhen në pajtim me realizimin e punimeve/furnizimeve sipas kushteve të kontratës. Pagesat bëhen nga MMPHI-ja deri në vlerën e financimit sipas nenit 2, paragrafit 1 dhe 2 të këtij Memorandumi.
4. MMPHI-ja cakton një zyrtar për mbikqyrjen e realizimit të projekteve nga fillimi deri në përfundim të kontratës. MMPHI-ja me vendim do të caktoj detyrat, përgjrgjësitë dhe autorizimet e zyrtarit për mbikqyrje.

Neni 4
Obligimet e Komunës

1. Komuna siguron deklaratën e disponueshmërisë së mjeteve në tërësinë e vlerës së projektit dhe një kopje e dërgon në MI.
2. Komuna obligohet ti krijoj kushtet e nevojshme për realizimin e projekteve për operatoret ekonomik, të ndërmerr te gjitha masat që kontraktuesi pa pengesë të filloj në implementimin e projekteve me kohë si dhe të siguroj specifikacionet teknike.

11. Komuna obligohet të ndërmarrë dhe kryej çdo lloj shpronësimi të nevojshëm për zbatimin e projekteve përfshirë procedurat dhe kompenzimin.

Neni 5
Ndryshimet dhe ndërprerja e Memorandumit të Mirëkuptimit

1. Me pëlqimin paraprak të Ministrit të MMPHI-së dhe Kryetarit të Komunës, ky Memorandum mund të ndryshohet dhe plotësohet.
2. MMPHI-ja mbanë të drejtën e ndërprerjës së shfrytëzimit të buxhetit për këtë destinim në rast se konstaton se Komuna nuk i përbush obligimet e veta të dala nga ky Memorandum.

Neni 6
Zgjidhja e kontesteve

Palët janë pajtuar në mes veti që ky Memorandum të zgjidhet me mirëkuptim.

Neni 7
Numri i Kopjeve

Memorandumi i Mirëkuptimit është nënshkruar në katër (2) kopje, nga një (1) kopje për secilën palë nënshkruese.

Neni 8
Pronësia e Projektit

1. Me pranim dorëzimin e punëve të kryera nga operatori ekonomik, ky investim (projekt) do të kaloje në pronësi të Komunës.
2. Ky investim regjistrohet në pronësi të Komunës në mënyrë elektronike dhe fizike në sistemin e pasurisë në Ministrin e Financave dhe Transfereve (SMIFK).

Neni 9
Hyrja ne fuqi

Palët nënshkruese janë pajtuar që ky Memorandum i Mirëkuptimit të fillon të zbatohet nga dita e nënshkrimit.

Ministri i MMPHI-së

Kryetari Komunës





Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government


MINISTRIA E MJEDISIT, PLANIFIKIMIT HAPËSINOR DHE INFRASTRUKTURËS
MINISTARSTVO ŽIVOTNE SREDINE, PROSTORNOG PLANIRANJA I INFRASTRUKTURE
MINISTRY OF ENVIRONMENT, SPATIAL PLANNING AND INFRASTRUCTURE



2962-24

KUVENDI KOMUNAL
LIPJAN

R 6238438



* 6 2 3 8 4 3 8 *



Komuna e Lipjanit

REPUBLIKA E KOSOVES
REPUBLIKA KOSOVO
OPŠTINA LIPLJAN

Pranuar me: Primljen:	11.06.2024	
Mjësia Jednica	Numri Broj	Shtojca Dodatak
01-553/01-28506		



MEMORANDUM MIRËKUPTIMI

lidhur ndërmjet

Komunës së Lipjanit

dhe

Humanity First

Për shpërndarjen e produkteve të mishit për **50 familje** në nevojë të
Komunës së Lipjanit në prag të festës së Kurban Bajramit

Lipjan, Qershor 2024

Qëllimi

1. Qëllimi i Memorandumit të Mirëkuptimit ndërmjet Komunës së Lipjanit dhe Humanity First është furnizimi me produkte të mishit të cilat do t'u shpërndahen familjeve në nevojë dhe që jetojnë me assistencë sociale në Komunën e Lipjanit.

Lloji i donacionit

1. Pakot të cilat përbajnë produkte të mishit do të dhurohen nga donatori i lartëcekur përkatësisht Organizata Humanity First dhe do të shpërndahen gjithsej **50 pako**. Për çdo familje do të shpëndahet një pako me produkte të mishit. Një pako peshon **5kg** dhe përmban: 2kg mish tul, 1kg qebapa, 1kg qyfte dhe 1kg suxhuk. 1 Pako ka vlerë rreth **35 euro**.

Orari i implementimit të donacionit

1. Në pajtim me të dyja palët e lidhjes së këtij memorandumi mirëkuptimi është caktuar që shpërndarja e pakove me produkte të mishit të bëhet **ditën e enjte, me datë: 13.06.2024, në orën 14:00**

Komuna e Lipjanit zotohet për të ofruar mundësitet e mëposhtme:

1. Për komisionin prej tre anëtarësh që do të bëjnë përgatitjen e listës së **50 familjeve** në

nevojë që janë pranuese të donacionit, do të caktojë një anëtar. Anëtari i caktuar është: **Avni Jashari**

2. Të jenë të përpiktë në respektim të orarit dhe datës së caktuar të shpërndarjes së pakove ushqimore;
3. Angazhon së paku një zyrtar social për të ndihmuar shpërndarjen e pakove në terren;
4. Monitoron shpërndarjen e pakove me produkte mishi dhe kujdeset të regjistrojë emrin dhe mbiemrin e përfituesit, numrin e anëtarëve të shtëpisë së përfituesit, numrin personal të përfituesit, vendbanimin dhe nënshkrimin e përfituesit.

Humanity First zotohet për të sigruuar mundësitet e mëposhtme:

1. Për komisionin prej tre anëtarësh që do të bëjnë përgatitjen e listës së **50 familjeve** pranuese të donacionit që janë në nevojë dhe me asistencë sociale, do të caktojë dy anëtarët e caktuar janë:
 1. **Besmir Yvejsi;**
 2. **Jinahuddin Saif.**
2. Përmes ndërmarrjes private ETC siguron produktet e mishit;
3. Përmes ndërmarrjes private ETC siguron transportimin e produkteve të mishit me automjet frigodhomë që i mban të freskëta produktet e mishit gjatë transportimit dhe shpërndarjes;
4. Të jenë të përpiktë në respektim të orarit dhe datës së caktuar të shpërndarjes së pakove me produkte të mishit;
5. I përbahet të gjitha zotimeve të marra përsipër në këtë marrëveshje.

Dispozita përfundimtare

1. Ky memorandum është nënshkuar në katër (4) kopje origjinale, në gjuhën shqipe.

Hyrja në fuqi

Memorandumi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga palët, ndërkohë zbatimi i saj fillon me datë **13.06.2024, ora 14:00**.

Vendtakimi i fillimit të shpërndarjes së pakove me produkte të mishit është: **Tregu i ri në Lipjan.**

Lipjan

Datë: 11.06.2024

Komuna e Lipjanit

(Diamant Bytyqi, nënkyrytar)

Humanity First



(Besmir Yvejsi)



REPUBLIKA E KOSOVES
REPUBLIQUE DU KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVO
OPŠTINA LIPLJAN

Kompania Rajonale e Mbeturinave
Regionalna Kompanija za Uklanjanje Čvrada

"PASTRIMI" sh.a. d.d.
Nr.br. 3023 dt. 29.06.2024
Prishtinë - Pristina

KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Pranuar më: Primiljeno:	26.06.2024	
Njësia Jednica	Numri Broj	Sntoja Dodatak
01-352/01-30507		



KOMPANIA REGIONALE PASTRIMI

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

E lidhur ndërmjet:

1. Komuna e Lipjanit, në tekstin vijues "Komuna" të cilën e përfaqëson, Kryetari i Komunës z. Imri Ahmeti,

2. KRM "Pastrimi" SH.A.-Prishtinë, në tekstin vijues "Kompania" të cilën e përfaqëson z. Petrit Reçica, Kryeshef Ekzekutiv, si vijon:

Neni 1
Qëllimi

Qëllimi i kësaj Marrëveshje është që Komuna e Lipjanit t'i jap në shfrytëzim KRM "Pastrimi" SH.A.-Prishtinë – Njësia në Lipjan kontenjerët, me shënimet si vijon:

Artikulli Nr.	Përshkrimi	Copë	Çmimi për njësi me TVSH	Totali
1.	Kontenjerë 1.1 m ³ metalik	117	421.00 €	49,257.00 €
2.	Kontenjerë të plastikës 120 L	1100	26.89 €	29,579.00 €
			Shuma totale:	78,836.00 €

Neni 2
Obligimet e Komunës

Komuna Lipjanit me këtë Marrëveshje obligohet që i jep në shfrytëzim KRM "Pastrimi" SH.A.-Prishtinë – Njësia në Lipjan, kontenjerët e cekur në nenin 1 të kësaj Marrëveshje të cilat janë përfituar nga Granti i Performancës për Mjedis të Pastër nga Ministria e Mjedisit

Planifikimit, Hapësinor dhe Infrastrukturës me të drejtë të shfrytëzimit për nevojat e kompanisë për kryerjen e shërbimeve efikase dhe kualitative në tërë territorin e Komunës së Lipjanit.

Neni 3
Obligimet e Kompanisë "Pastrimi" Sh. A Prishtinë

KRM "Pastrimi" SH.A.-Prishtinë obligohet të marrë në shfrytëzim kontenjerët e cekur në nenin 1 të kësaj Marrëveshje, për kryerjen e shërbimeve efikase dhe kualitative për qytetarët e Komunës së Lipjanit.

Neni 4
Ndryshimi dhe Përfundimi

1. Kjo Marrëveshje bashkëpunimi mund te ndryshohet vetem me shkrim.
2. Kjo Marrëveshje bashkëpunimi mund të jetë zgjidhur nga çdo palë me kushtin që të njoftojë palën tjeter me shkrim 30 (tridhjetë) ditë përpara.

Neni 5
Hyrja në fuqi

1. Marrëveshja hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga palët.
2. Marrëveshja është hartuar në dy (2) kopje identike origjinale dhe secila nga palët marrin nga një (1) kopje.

Nënshkruar:

Kryetar i Komunës së Lipjanit
Z. Imri Ahmeti



Kryeshef Ekzekutiv KRM "Pastrimi" SH.A.-
Z. Petrit Reçica



2024